



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3126 Prot.

Patos, më 20/10 / 2025



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT – VENDIM

Nr. 67, datë 20/10 / 2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT 2025-2029

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të pikës “k” nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 73, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar;

KËRKOJMË

1. Të miratojë planin 5- vjeçar të strehimit 2025 – 2029, pjesë përbërse e projektvendimit.

Grupi i punës

Kryetar

Ina Sauli

Anëtar

Anisa Kripa

Anëtar

Ermenita Mici

Anëtar

Andi Kola

Anëtar

Fabjola Hoxha

Anëtar

Arben Shpërdheja

Juriste

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3126 / Prot.
11

Patos, më 20 / 10 / 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E PLANIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT 2025-2029
KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9 dhe nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 73, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar, urdhërit nr. 2625 prot., datë 28.08.2025 hartohet ky planë 5- vjeçar i strehimit 2025 – 2029.

Hartimi i këtij plan 5- vjeçar i strehimit 2025-2029 mbështetet në pesë pika.

- 1- Profilizimi i bashkisë Patos
- 2- Analiza e vlerësimit
- 3- Kushtet aktuale
- 4- Qëllimi
- 5- Objektivat

Referenca

MFE, 2016-2025: Strategjia Kombëtare e Strehimit Social MFE, UNDP,

2021: Udhëzuesi për Strehimin Social në nivel Bashkie, Leave no one behind.

Regjistri i Gjendjes Civile Bashkia Patos, viti 2025

Ligji nr. 22/ 2018 “Për strehimin Social”

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

1- Profilizimi i bashkisë Patos

Bashkia Patos ka një popullsi prej 42,197 banorësh¹, pjesë e 13,964 familjeve. Ajo është e organizuar në tre njësi administrative, Njësia Administrative Patos, Njësia Administrative Ruzhdie dhe Njësia Administrative Zharrëz. Ka një shpërndarje të pabarabartë të popullsisë në territorin e tre njësive administrative të bashkisë Patos. Specifikisht:

¹ Burimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile qershor 2025

Njësitë Administrative	Qytetet dhe fshatrat	Popullsia	Përqindja
Patos	Patos, Dukas, Kuqar, Rerës, Grizë, Margëlliç, Banaj, Rusinjë	30,646	72.6%
Zharrëz	Voselë, Zharrëz, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë	8,810	20%
Ruzhdie	Ruzhdie, Gjynqarë, Siqecë, Drenie, Kasnicë	3,241	7.5%

Të dhënat e Censurit për vitin 2023 janë 24,199 banorë dhe tregojnë që numri i popullsisë që jeton realisht në territorin e bashkisë është më i ulët, për shkak të migrimit dhe emigrimit.

Duke mbajtur në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, por edhe situatën e grupeve në nevojë në territorin e saj, bashkia Patos e konsideron të rëndësishëm planifikimin e strehimit.

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për strehim në territorin e bashkisë të identifikuar përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimeve me stafin dhe aktorët e tjerë, bashkia Patos përcaktoi dhe adreson përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të strehimit social, pjesë e Plani 5- vjeçar i strehimit 2025-2029.

2- Analiza e vlerësimit

Plani 5-vjeçar i Strehim 2025-2029 do të shoqërohet me një Plan Veprimi të kostuar, i cili përkthehet në masa konkrete të angazhimit të marrë për të garantuar dhe ofruar strehimin e përbalueshëm me cilësi për të gjitha shtresat në nevojë. Gjithashtu, ky dokument hedh piketat për investime të qëndrueshme dhe afatgjata në sektorin e strehimit.

Analiza e situatës mbështetet në shqyrtimin e dokumentave, analizimin e të dhënave të grumbulluara ndër vite nga bashkia Patos, aplikantëve dhe përfituesve sipas programeve të strehimit social. Analiza e situatës hedh dritë mbi kërkesën dhe ofertën për strehim social në nivel vendor, si dhe mbi sistemin e pikëzimit të aplikantëve, buxhetin për strehimin social, inventarin e banesave sociale dhe truallit. Vlerësimi hodhi dritë mbi karakteristikat e familjeve përfituese, kapacitetet e njësisë vendore për sigurimin e strehimit social, shpërndarjen e buxhetit për strehim social, transparencën dhe sigurinë e informacionit, si dhe marrëdhënien mes qeverisë vendore e asaj qendrore.

Sfida kryesore është njohja e qartë e ofertës dhe kërkesës për strehim social.

Qeveria ka ngritur disa programe sociale strehimi. Bazuar në kërkesat e qytetarëve aplikant, në bashkinë Patos interes të shtuar kanë banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe rikonstrukcion i banesave për familjet në nevojë. Përfituesit e programeve sociale të strehimit janë kryesisht familje që përmbushin njërin prej kriterëve të mëposhtëm: nuk kanë në pronësi një banesë, zotërojnë sipërfaqe banimi në norëm më të ulët se standardi i përcaktuar, nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar strehimin në tregun e lirë, ose janë pjesë e një kategorie sociale të veçantë që e bënë të domosdoshëm përfshirjen në

procesin e strehimit social. Përzgjedhja e përfituesve përcaktohet në bazë të sistemit të pikëzimit të miratuar me VKB sipas legjislacionit në fuqi. Sistemi i vlerësimit me pikë është krijuar për t'u dhënë përparësi grupeve që ndodhen në pozita të pafavorshme. **Pronat e bashkisë Patos nuk janë të regjistruara në mënyrë përfundimtare. Mungojnë shoqëritë e ndërtimit.**

Ky është plani i dytë 5-vjeçar për bashkinë Patos.

Nisur nga objektivat e planit 5-vjeçar 2019-2024 realizimet e arritura ishin të kënaqshme:

- Përfundimisht me planin e strehimit 2019-2023 u bë e mundur rikonstrukcioni i 3 objekteve ku u përfituan 59 apartamente me qira me bashkëfinancim, si dhe rikonstrukcioni i 33 banesave individuale në total me bashkëfinancim dhe me fondet nga vetë bashkia për familjet në nevojë. Përfitues direkt ishin nga të gjitha grupet shoqërore në një numër total prej 245 frymë.

➤ Bashkia	Viti	Objekte të rikonstruktura/Apartamente	Banesa Individuale
Patos	2019	12	
Patos	2020	14	
Patos	2021	31	
Patos	2022		20
Patos	2025		20

3- Kushtet aktuale

Është paraqitur në mënyr tabelare për vitin 2024 - 2025 kërkesit dhe përfituesit sipas programeve të strehimit. Janë paraqitur gjithashtu në mënyr tabelare dhe objektet e transferuara për strehim bashkisë Patos sipas vkm 443 të inventarizimit të pronave.

4- QËLLIMI

Qëllimi i Planit të Strehimit Social është përmirësimi i kushteve të jetesës së rreth 230 familjeve në bashkinë Patos me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë (duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara, që vuajnë nga përjashtimi social), përmes ofrimit të alternativave për strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm. Parime udhëzuese kryesore në një sektor strehimi social funksional janë: **gatishmëria, përballueshmëria dhe arritshmëria.**

- a) **Gatishmëria** Në kontekstin e strehimit social është qartazi e rëndësishme që banesat t'u jepen përfituesve të synuar. Gatishmëria e banesave është një çështje që lidhet në mënyrë specifike me vendndodhjen.
- b) **Përballueshmëria.** Strehimi i përballueshëm me cilësi të mirë, pasja e një shtëpie me kosto të përballueshme siguron stabilitet, pozitiv për familjet përfituese. Është e rëndësishme që të shqyrtohet përballueshmëria e kësteve mujore (për banesat me kosto të ulët) me kalimin e kohës, por edhe kostot e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesës.

- c) **Arritshmëria.** Në strehimin social arritshmëri quhet tërësia e rregullave dhe rregulloreve që u mundësojnë familjeve të kualifikohen dhe të përzgjidhen për strehim social. Identifikimi i grupeve të nënsynuara dhe vendosja e prioriteteve, si edhe vendosja e kuotave për grupet specifike të synuara, mund të rrisin arritshmërinë.

5 -OBJEKTIVAT

- ❖ Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe në bashkinë Patos.
- ❖ Vlerësimi i nevojave për strehim në bashkinë Patos, fokusimi i grupeve në pozita të pafavorizuara.
- ❖ Mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në bashkinë Patos.
- ❖ Reduktimi i familjeve të pastreha

Për vitin 2025 – 2029 synohet rikonstruksion banese për 60 familje në nevojë nga të gjitha grupet shoqërore, si dhe rikonstruksionin e ish kaponit në lagjen 29 Marsi. Do të krijohet një fond strehimi.

Grupi i punës

Kryetar

Ina Sauli

Anëtar

Anisa Kripa

Anëtar

Ermenita Mici

Anëtar

Andi Kola

Anëtar

Fabjola Hoxha

Anëtar


Arben Shpërdheja

Juriste

Nurkë Hazizaj

KRYETARI
Fation Duro





BASHKIA PATOS

PLANI 5-VJEBËAR I STRBHIMIT

2025-2029



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro



PLANI 5 - VJEÇAR I STREHIMIT

2025-2029

FAZAT E PLANIT TË STREHIMIT

- 1-PROFILI I BASHKISË**
- 2- ANALIZA E VLERËSIMIT**
- 3- KUSHTET AKTUALE**
- 4-QËLLIMI**
- 5-OBJEKTIVAT**

HYRJE

Një ndër detyrat kryesore të Bashkisë Patos për sektorin e strehimit është hartimi i programit 5-vjeçar të strehimit social në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i këtij programi shërben si kusht kryesor për përfitim të fondeve nga Qeveria Qendrore në lidhje me gjashtë programet aktualisht të përcaktuara në ligjin për strehimin social. Gjithashtu, programi i mundëson bashkisë identifikimin e nevojave specifike për strehim social dhe planifikimin buxhetor për to. Sipas ligjit nr. 22/2018, 'Për Strehimin Social', neni 68, programi lokal 5-vjeçar i strehimit duhet të përmbajë:

- a) burimet e financimit, që përfshijnë fonde nga buxheti i shtetit, fondet e siguruar nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe fonde nga burime të tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;
- b) nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;
- c) lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe mënyrën e ndikimit të tyre te njëra-tjetra;
- d) masën e rritjes së fondit publik të banesave, brenda një viti financiar, me ndërtesa që do të jepen me qira, uzufrukt ose huapërdorje, si dhe numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përftojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;
- e) numrin e familjeve që do të përftojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;
- f) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfutjesve për shlyerjen e qirave ose interesave të kredive me kushte lehtësuese;
- g) numrin dhe sipërfaqet e trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përftojnë formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve;
- h) numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfutjesve;
- i) numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përftojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;
- j) numrin e banesave që do të përftohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;
- k) numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese

1- PROFILI I BASHKISË

Bashkia Patos ka një popullsi prej 42,197 banorësh¹, pjesë e 13,964 familjeve. Ajo është e organizuar në tre njësi administrative, Njësia Administrative Patos, Njësia Administrative Ruzhdie dhe Njësia Administrative Zharëz. Ka një shpërndarje të pabarabartë të popullsisë në territorin e tre njësive administrative të bashkisë Patos. Specifikisht: 30,646 banorë, ose 72,6% e banorëve jetojnë në Njësine Administrative Patos, 8,810 banorë, ose 20% e banorëve jetojnë në Njësine Administrative Zharës dhe 3241 banorë ose 7,5% të banorëve jetojnë në Njësine Administrative Ruzhdie. Duke iu referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe numrit të familjeve, mesatarja e pjesëtarëve për familje në bashkinë Patos është 3,08 banorë për familje.

Të dhënat e Censurit për vitin 2023 janë 24,199 banorë dhe tregojnë që numri i popullsisë që jeton realisht në territorin e bashkisë është më i ulët, për shkak të migrimit dhe emigrimit.

Duke mbajtur në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, por edhe situatën e grupeve në nevojë në territorin e saj, bashkia Patos e konsideron të rëndësishëm planifikimin e strehimit.

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për strehim në territorin e bashkisë të identifikuar përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimeve me stafin dhe aktorët e tjerë, bashkia Patos përcaktoi dhe adreson përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të strehimit social, pjesë e Planit 5-vjeçar i strehimit 2025-2029.

Pavarësisht përpjekjes për të mbledhur të dhëna sa më të plota për të identifikuar grupet në nevojë për strehim social në territorin e bashkisë Patos, ka një pranim të përgjithshëm që të gjithë aktorët e përfshirë në proces që mund të egzistojnë në territor grupe të tjera në nevojë për strehim social që nuk janë identifikuar ende, për disa arsye të veçanta. Për disa grupe në nevojë që edhe pse ekzistojnë, nuk regjistrohen ose nuk parqesin dokumentacionin e kërkuar nga ana ligjore.

<i>Tabela 1. Të dhënat për Bashkinë Patos</i>		
Njësité Administrative	Qytetet dhe fshatrat	Popullsia
Patos	Dukas, Kuqar, Rerës, Grizë, Margëlliq, Banaj, Rusinjë	30,646
Zharëz	Voselë, Zharëz, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë	8810
Ruzhdie	Ruzhdie, Gjynqarë, Siqecë, Drenie, Kasnicë	3241

¹ Burimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile qershor 2025

82.55 km²
18 fshatra
42,197 banorë




Foto-1 Harta territoriale e Bashkisë Patos



Foto-2 Vendodhja e Banesave Sociale

Situata e strehimit në bashki lidhet ngushtë me ndryshimin e popullsisë dhe kryesisht nevojës për përmirësime të banesave. Popullsia ka pasur ndryshime vërejtë të fundit dhe këto tendenca lidhen me fenomenin e migrimit të brendshëm nga zonat rurale të largëta drejt zonave urbane. Si rezultat edhe nevoja për strehim dhe kërkesat për këtë shërbim kanë ardhur në rritje. Rritja e kërkesës për strehim social është rritur edhe për shkak të kompleksitetit të strukturës sociale të familjeve dhe grupeve në nevojë, po aq edhe me tregun jo të përballeshëm nga popullsia në rritje. Edhe pse kërkesa ka ardhur në rritje bashkia Patos nuk është në pozitë të favorshme të mundshme sa i përket buxhetit për strehimin social. Për të përballuar sfidën e strehimit social nevojitet bashkëpunimi mes aktorëve

publike e private dhe midis niveleve vendore dhe qendrore të qeverisjes. Në zonat rurale disa nga sfidat që mund të hasin këto njësi administrative janë:

- Kalimi i të drejtave të pronësisë, që kërkojnë ndërhyrjen e pushtetit qendror.
- Cilësi jo e mirë strukturore e banesave, të cilat kanë të ngjarë të shemben ose të jenë në rrezik shembjeje.
- Kushtet shëndetësore dhe sanitare të banesave janë më të ulëta.
- Akseset në shërbimeve publike dhe sociale është më i ulët.

2- ANALIZA E VLERËSIMIT

● Plan i 5-vjeçar i Strehimit 2025-2029 do të shoqërohet me një Plan Veprimi të kostuar, i cili përkthehet në masa konkrete të angazhimit të marrë për të garantuar dhe ofruar strehimin e përballeshëm me cilësi për të gjitha shpresat në nevojë. Gjithashtu, ky dokument hedh piketat për investime të qëndrueshme dhe afatgjata në sektorin e strehimit.

Analiza e situatës mbështetet në shqyrtimin e dokumentave, analizimin e të dhënave të grumbulluara ndër vite nga bashkia Patos, aplikantëve dhe përfutjesve sipas programeve të strehimit social. Analiza e situatës hedh dritë mbi kërkesën dhe ofertën për strehim social në nivel vendor, si dhe mbi sistemin e pikëzimit të aplikantëve, buxhetin për strehimin social, inventarin e banesave sociale dhe tregun. Vlerësimi hodhi dritë mbi karakteristikat e familjeve përfuttese, kapacitetet e njësisë vendore për sigurimin e strehimit social, shpërndarjen e buxhetit për strehim social, transparencën dhe sigurinë e informacionit, si dhe marrëdhënien mes qeverisë vendore e asaj qendrore.

Sfida kryesore është njohja e qartë e ofertës dhe kërkesës për strehim social.

Bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin Social”, programet e strehimit janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike ose sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekare.

Qeveria ka ngritur disa programe sociale strehimi. Bazuar në kërkesat e qytetarëve aplikant, në bashkinë Patos interes të shtuar kanë banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe rikonstrukcion i banesave për familjet në nevojë. Krahës këtyre, qeveria ka

krijuar edhe instrumente si subvencionet e strehimit, kreditë me subvencionuar, granteve të vogla dhe granteve të menjëhershme që kanë për qëllim emergjencia të caktuara. Përfutjesit e programeve sociale të strehimit janë kryesisht familje që pëmbushin njërin prej kriterëve të mëposhtëm: nuk kanë në pronësi një banesë, zotërojnë sipërfaqe banimi në një norëm më të ulët se standardi i përcaktuar, nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar strehimin në tregun e lirë, ose janë pjesë e një kategorie sociale të veçantë që e bënë të domosdoshëm përfshirjen në procesin e strehimit social.

Përzgjedhja e përfutjesve përcaktohet në bazë të sistemit të pikëzimit të miratuar me VKB sipas legjislacionit në fuqi. Mbështetet tek kushtet e tyre jetësore si edhe tek rrethanat e tyre ekonomike dhe sociale. Prioritet u jepet grupeve të përfshirë: familjet me një prind të vetëm, familjet e mëdha, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendqëndrim, jetimët, emigrantët e rikthyer, punëtorët migrues, azilkërkuesit, oficerët e rënë në detyrë, viktimat e dhunës në familje, familjet romë, familjet egjiptiane, viktimat të trafikimit, punonjës të Reneas, punonjës të shpëtimit dhe mbrojtjes së zjarrit, punonjës të FNSH, vajzat –nëna, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe komuniteti LGBT. Programet e strehimit social janë të diferencuara sipas karakteristikave të grupeve përfuttese, duke garantuar një shpërndarje sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të mbështetjes sociale.

“Strehimi social është një alternativë strehimi që mund të përdoret nga çdo person që nuk është pronar i një banese, e cila ofrohet nga qeverisja vendore ose sektori privat për familjet me të ardhura të ulëta që nuk mund të blejnë një shtëpi në mënyrë të pavarur në tregun e lirë ose për familjet e përjashtuara nga tregu i banesave për shkak të pozitës së tyre pafavorshme që çon në përjashtim. Financimi ofrohet nga qeverisja qendrore dhe mund të plotësohet nga qeverisja vendore. Përmes kësaj, agjencitë (gjysmë) shtetërore, si Enti Kombëtar i Banesave, ofrojnë masa të tjera financimi për të mbështetur strehimin social.”

Projekti e përfutur nga Qeveria Qendrore në Bashkinë Patos për programet e strehimit

Bashkia	Viti	Objekte të rikonstruktuar/Apartamente	Banesa Individuale
Patos	2019	12	
Patos	2020	14	
Patos	2021	31	
Patos	2022		20
Patos	2025		20

Këto grupe vulnerabel nuk janë të vetmet të cilat kanë nevojë për shërbimin e strehimit social dhe për vitin 2025, për muajt Janar-Gusht kanë aplikuar 113 individë të interesuar për Programin e Përmirësimit të kushteve të banimit.

Përgjegjësia e ofrimit të strehimit social ndahet midis qeverisjes qendrore dhe njërive vendore. Pushteti qendror është përgjegjës për krijimin e një programi strehimi afatgjatë, shpërndarjen e fondeve për zbatimin e programeve sociale të strehimit, përcaktimin e rregullave për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, grumbullimin e të dhënave për administrimin e kërkesave për strehim, zhvillimin e një inventari të banesave në nivel kombëtar, caktimin e kostos mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave, përgatitjen e kriterëve për strehimin, ose blerjen e banesave me kosto të ulët, të cilat financohen nga buxheti i shtetit, dhe mbikëqyrjen e investimeve për strehimin social, të financuara ose bashkëfinancuara nga qeveria.

Autoritetet vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim, krijimin e programeve dhe projekteve afatmesme dhe afatgjata, ofrimin e trullit të lirë për ndërtim, paraqitjen e kërkesave për financime, investime dhe subvencione të qeveria qendrore, zhvillimin dhe administrimin e një inventari të dhënave, përcaktimin e kostos maksimale të ndërtimit të banesave, ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale që u janë caktuar, dhe informimin e Ministrisë së Linjës në lidhje me ecurinë e programeve të strehimit. Njësitë vendore duhet të krijojnë një bazë të dhënash për të mbajtur evidencat e kërkesave për strehim dhe të dhënave të tjera, numrin dhe llojin e familjeve që do të përfitojnë nga një shtëpi dhe për shkak të mungesës së burimeve financiare, nevojat për strehim dhe përgjegjësinë për administrimin e kërkesave për strehimin social dhe përcaktimin e grupeve që do të kenë përparësi. Këshilli bashkiak miraton sistemin e vlerësimit me pikë.

Sistemi i vlerësimit me pikë është krijuar për t'u dhënë përparësi grupeve që ndodhen në pozita të pafavorshme. *Për shembull*, njësitë vendore mund të vendosin t'u japin prioritet (d.m.th. t'u caktojnë pikë më të larta) grave kryefamiljare dhe jo personave që jetojnë mbi normalat e strehimit. Kjo ndikon në probabilitetin e përzgjedhjes së tyre; sa më i lartë të jetë numri i pikëve, aq më i madh është probabiliteti që ata të përfitojnë strehim social.

Programi i banesave sociale me qira krahasuar me programin e banesave me kosto të ulët, ka më shumë gjasa të ketë në fokus familjet me të ardhura të ulëta. Fuqizimi i instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorshme duhet të përbëjë prioritet. Në vendet Europiane aplikohen forma të ndryshme të instrumenteve financiare, si përfashimi nga taksat. Çështje tjetër e strehimit është kryesisht mospërputhja midis kërkesës dhe ofertës, që lidhen me vendndodhjen (banesat nuk janë të gatshme aty ku nevojiten).

Si problemim kryesor në ofrimin e strehimit social mbetet mungesa e fondeve për t'i zgjeruar programet sociale.

Pronat e bashkisë Patos nuk janë të regjistruara në mënyrë përfundimtare.

Mungojnë shoqëritë e ndërtimit.

Bashkia ka shprehur vullnetin të bashkëpunojnë me Entin Kombëtar të Banesave dhe shoqëritë e ndërtimit për të zgjidhur problemat e strehimit, duke ofruar truall të lirë për ndërtim. Për këtë arsye, disa dallime, banesat në zonat rurale kanë më tepër të ngjarë të shemben ose të jenë në rrezik shembjeje për arsye të moshës së tyre.

Ky është plani i dytë 5-vjeçar për bashkinë Patos.

Nisur nga objektivat e planit 5-vjeçar 2019-2023 realizimet e arritura ishin të kënaqshme:

- Përfundoi rikonstrukcioni i objektit shkalla 1 në ish qendrën e kualifikimit në lagjen e re, me bashkëfinancim me pushtetin qendror, ku u përfituan 14 apartamente me qira.
U strehuan 14 familje me një numër prej 51 frymë (nga të gjitha kategoritë).
 - Përfundoi rikonstrukcioni i objektit shkalla 2 në ish qendrën e kualifikimit në lagjen e re, me bashkëfinancim me pushtetin qendror, ku u përfituan 31 apartamente me qira.
U strehuan 31 familje me një numër prej 71 frymë (nga të gjitha kategoritë).
 - Përfundoi projekti me bashkëfinancim me pushtetin qendror “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese për familjet në nevojë” ku përfituan 20 familje, me një numër total 72 frymë.
 - Përfundoi rikonstrukcioni i objektit ish kopështi në lagjen M. Matohiti, me fondet e bashkisë, ku u përfituan 2 apartamente me qira, përfutues 1 familje, me një numër total 5 frymë.
 - Bazuar në këtë plan, u arriti mbështetja për rikonstrukcion të banesave për 13 familjet në nevojë, me një numër total prej 46 frymë me fondet e institucionit sipas buxheteve vjetore të alokuara për strehim.
- Përfundimisht me planin e strehimit 2019-2023 u bënë mundur rikonstrukcioni i 3 objekteve ku u përfituan 59 apartamente me qira me bashkëfinancim, si dhe rikonstrukcioni i 33 banesave individuale në total me bashkëfinancim dhe me fondet nga vetë bashkia për familjet në nevojë. Përfutues direkt ishin nga të gjitha grupet shoqërore në një numër total prej 245 frymë.

3- KUSHTET AKTUALE

Në bashkinë Patos, numri i kërkesve për të gjitha programet e strehimit social, gjatë periudhës deri në vitin 2024 është aktualisht 137 (njëqindë e tridhjetë e shtatë) familje.

Tabela 1 : 2024 Kërkesit dhe përfutuesit, sipas programeve.

Programi	Numri i kërkesve	Numri i përfutuesve	% e përfutuesëve
Banes sociale me qira	75	55	73.3%
Banesa me kosto të ulët	8	0	0%
Subvencion qira banese	2	2	100%
Truall i pajisur me infrastrukturë	-	-	-%
Rikonstruksion banesash	52	34	65.4%
Gjithsej	127	91	71.6%

Tabela 2: 2025 Kërkesit dhe përfutuesit, sipas programeve.

Programi	Numëri i kërkesve	Numri i përfutuesve	% e përfutuesëve
Banes sociale me qira	74	60	81%
Banesa me kosto të ulët	0	0	0%
Subvencion qira banese	2	2	100%
Truall i pajisur me infrastrukturë	0	0	0%
Rikonstruksion banesash	37	19	51%
Gjithsej	113	81	71.7%

Tabela 1.1: Kërkesit dhe përfutjesit, sipas grupeve 2024

Grupi	Numri i kërkuarve (familje)	Numri i përfutjesve (familje)	Përqindja e përfutjesve
Familje me kryefamiljare femër	38	32	84.2%
Familje me një prind të vetëm	40	34	85 %
Familje të mëdha	10	7	70%
Të moshuar	17	10	58.8%
Persona me aftësi të kufizuara	19	16	84,2%
Çifte në moshë të re	3	3	100%
Familje që kanë ndryshuar vendqëndrim	5	1	20%
Jetimë	0	0	0%
Emigrantë të rikthyer	0	0	0%
Punëtorë migruar	0	0	0%
Azilkërkuar	0	0	0,0%
Anëtarë të familjeve të oficerëve të rënë në krye të detyrës	0	0	0,0%
Viktima të dhunës në familje	2	2	100%
Familje romë	0	0	0%
Familje egjiptiane	0	0	0%
Përfutjes të ndihmës ekonomike	25	20	80%
Grupe të tjera	20	7	35%

Tabela 1.2: *Kërkesit dhe përfuturit, sipas grupeve 2025*

Grupi	Numri i kërkuarve		Numri i përfuturave		Përqindja e përfuturave
	(familje)	(familje)	(familje)	(familje)	
Familje me kryefamiljare femër	33	25	75.7%		
Familje me një prind të vetëm	30	21	70.0%		
Familje të mëdha	6	6	100.0%		
Të moshuar	14	11	78.5%		
Persona me aftësi të kufizuara	20	12	60%		
Çifte në moshë të re	4	4	100%		
Familje që kanë ndryshuar vendqëndrim	1	0	0%		
Jetimë	1	1	100%		
Emigrantë të rikthyer	0	0	100%		
Punëtorë migruar	0	0	0%		
Azilkërkues	0	0	0.0%		
Anëtarë të familjeve të oficerëve të rënë në krye të detyrës	0	0	0.0%		
Viktima të dhunës në familje	2	2	100%		
Familje rome	0	0	0%		
Familje egjiptiane	5	3	60%		
Përfutur të ndihmës ekonomike	2	2	100%		
Grupe të tjera	30	8	26.6%		

Të dhënat tregojnë se përqindja më e lartë e përfrituesve i përket grupit të viktimave të dhunës në familje me 100%, jetimëve, çifelleve të reja me 100% si dhe grave kryefamiljare 78.5 % që kanë bërë kërkesë në programet e strehimit social dhe që kanë përfutur nga programet. Ndërkohë, përqindja më e ulët e përfrituesve u përket grupeve të familje që kanë ndryshuar vendqëndrim dhe grupeve të tjera shoqërore.

Përsa u përket grupeve të familjeve me aftësi të kufizuara dhe egjiptjane kërkesat e tyre janë marr parasyshë dhe janë trajtuar në mënyrë të veçantë dhe zë një masë 60% në zgjidhje.

Një prej programeve më të mëdha (programi me banesa me kosto të ulët) nuk është i përballueshëm për të varfërit; për këtë arsye, të varfërit nuk përfillojnë nga ky program. Gjithashtu, procedurat bankare janë tepër të gjata dhe të kushtueshme.

Programi i banesave sociale me qira ka më shumë gjasa të ketë në fokus familjet me të ardhura të ulëta. Por megjithatë, njerëzit që jetojnë afër ose nën kufirin e varfërisë nuk mund ta përballojnë këtë program.

Subvencionet e strehimit shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Nuk ka ndonjë rregull për të dekurajuar varësinë ndaj programit.

Sipas gjendjes aktuale analitike kemi vrejtur se:

Me VKM nr. 443 dt. 15.06.2016 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Patos, të qarkut Fier”, për Njësinë Administrative Patos na u transferuan objektet e mëposhtme:

Ish shkolla 2-vjecare lagjia “29 Marsi”

Sipërfaqe: 528 m² (përdhese)

Nr	Emër	Mbiemër	Numri banorëve
1	Vasilika	Babaiu	5
2	Vasiliq	Sheqi	2
3	Josif	Sheqi	4
4	Edmond	Ymeraj	5
5	Kristaq	Vidhi	2
6	Bashkim	Skaci	5
7	Adriana	Dule	2
	7-Familje		25 frym

Lengu larës lagjia “29 Marsi”

Sipërfaqe: 250 m², (3- Kate)

Nr	Emër	Mbiemër	Numri banorëve
1	Vladimir	Salobehaj	5
2	Bardhyl	Grëmbi	3
3	Ylli	Bengaj	4
4	Idris	Zyka	4
5	Liri	Hajdini	1
6	Nexhip	Grëmbi	3
7	Ardiano	Bego	5
8	Daut	Rushiti	4
9	Tetem	Kuqari	2
10	Sulo	Demaj	2
11	Arif	Myrtaj	2
12	Ariana	Mucoglava	2
13	Luftar	Sinanaj	4
	13-Familje		41 frym

Ish zyrrat e NFP Lagjia 1 Maj

Sipërfaqe: 360 m² (2-Kate)

Nr	Emër	Mbiemër	Nr.banorëvë
1	Elgerta	Ajdinaj	4
2	Alket	Basha	1
3	Muhamet	Shehaj	5
4	Bujar	Shehaj	2
5	Bashkim	Xhelaj	2
6	Shpëtim	Çobaj	4
7	Demir	Ahmeti	4
8	Ibrahim	Gjata	6
9	Enver	Zenelaj	4
10	Sadik	Merkaaj	1
11	Nebi	Mukaaj	3
12	Bilbil	Resuli	3
13	Shkëndi	Vrapi	2
14	Aleksandër	Mitrushhi	3
15	Petraq	Kolloshi	1
16	Jetmor	Tahillari	1
17	Altin	Selimi	3
18	Enea	Pashaj	2
	18-Familije		51 frym

Ish zyrrat e N.M. Patos (transport) Lagjia “29 Marsi”

Sipërfaqe: 420 m² (2-Kate)

Nr	Emër	Mbiemër	Nr.banorëvë
1	Lefter	Ferataj	6
2	Namik	Ferataj	3
3	Vojsava	Berberi	2
4	Safet	Bregu	4
5	Agron	Gropa	4
6	Agron	Sabaj	3
7	Pelivan	Lalaj	4
8	Përparrim	Likaj	2
9	Andrea	Likaj	3
10	Petrit	Ahmetaj	4
11	Nikollaq	Giovashi	4
12	Flamur	Ramaj	4
13	Luljeta	Xhelaj	1
14	Kristaq	Dhanaj	3
15	Sokrat	Shpataraku	3
16	Kaliopë	Tole	2
17	Bledar	Gropa	4
18	Xhimi	Bilimani	4
19	Myseret	Rexhepai	4
20	Romeo	Shpataraku	1
21	Marijus	Kararaj	1
	21 - Familje		66 frym

Ish kapanon fjetore Lagjia “29 Marsi”
Sipërfaqe 300 m², (3-Kate)

Nr	Emër	Mbiemër	Nr.banorëvë
1	Sabri	Haxhiajaja	3
2	Eduart	Haxhija	5
3	Selfo	Troka	4
4	Pajtim	Haxhija	4
5	Liri	Rista	1
6	Viktor	Ngjela	4
7	Agim	Myrto	2
8	Kujtim	Sulovari	3
9	Vita	Hoxha	3
10	Veledin	Brakaj	6
11	Floranc	Hoxha	3
12	Artjon	Xhafa	4
13	Gëzim	Bejko	4
14	Elidon	Rizaj	1
15	Polikron	Matohitaj	4
16	Aldo	Halimi	1
17	Skënder	Muhaj	2
18	Ferman	Beqiraj	3
	18-Familje		57 frym

Ish mencia Nr. 6 Lagjia “29 Marsi”
Sipërfaqe 780 m², (2-Kate)

Nr	Emër	Mbiemër	Nr.banorëvë
1	Agim	Kaleni	4
2	Xhuljeta	Hysenaj	3
3	Agur	Myftaraj	3
4	Bari	Beraj	3
5	Shkelqim	Mucaj	8
6	Baki	Brahimaj	4
7	Altin	Kasaj	4
8	Estref	Kasaj	5
9	Gramos	Rushiti	4
10	Edmond	Bili	4
11	Refit	Çepele	2
12	Ilirjan	Seitaj	4
13	Jashar	Kasaj	4
14	Petit	Hazizaj	3
15	Novrus	Jaupaj	3
16	Xhevan	Kovaci	2
17	Vladimir	Mucaj	6
18	Selam	Hoxha	4
	18-Familje		70 frym

4-QËLLIMI

Qëllimi i Planit të Strehimit Social është përmirësimi i kushteve të jetesës së rreth 230 familjeve në bashkinë Patos me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë (duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara, që vuajnë nga përjashtimi social), përmes ofimit të alternativave për strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

Me qëllim arritjen dhe realizimin e këtij “Plani Strehimi” përmeshja e objektivave të tij, është përcaktuar një grup parimesh udhëzuese. Këto parime udhëzuese kryesore në një sektor strehimi social funksional janë: **gatishmëria, përballueshmëria dhe arritshmëria.**

Gatishmëria

Në kontekstin e strehimit social është gartazi e rëndësishme që banesat t’u jepen përfituesve të synuar.

Duhet bërë një dallim ndërmjet numrit të banesave sociale të dhëna nga bashkia (të shndërruara në banesa sociale, shpesh ndërtesa dikur në pronësi të shtetit), dhe subvencionimeve të qirasë, të cilat u jepen familjeve që kanë gjetur një banesë në treg dhe u ofrohet vetëm subvencion. Kupitimi i gatishmërisë së strehimit social shkon përtej vënies në dispozicion të banesave.

Gatishmëria e banesave është një çështje që lidhet në mënyrë specifike me vendndodhjen.

Përballueshmëria

Strehimi i përballueshëm me cilësi të mire, pasja e një shtëpie me kosto të përballueshme siguron stabilitet, pozitiv për familjet përfituese. Familjeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme mund t’u ofrohen si alternativë banesat me qira, me kusht që çmimet e banesave sociale me qira të jenë më të përballueshme sesa çmimet e tregut të lirë. Përballueshmëria mendohet të jetë rreth 15 deri në 20 për qind e të ardhurave mujore të familjeve. Përveç kësaj, është e rëndësishme që të shqyrtohet përballueshmëria e kësteve mujore (për banesat me kosto të ulët) me kalimin e kohës, por edhe kostot e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesës. Sa i përket

përballueshmërisë, elementet që shpesh anashkalohen përfshijnë faktin nëse mirëmbajtja është e përballueshme (qëndrueshmëri afatgjatë) ose nëse ofrohet mundësia për të marrë shërbimet bazë, si p.sh. energjia elektrike, ujë të pishem. Sa i përket arritshmërisë, sistemi i regjistrimit për strehim duhet të sigurojë ose të mbështesë pjesëmarrjen në shërbime të tjera, si formimi profesional, shkolla, kujdesi shëndetësor dhe në përgjithësi, hyrje në tregun e punës. Do të punohet për krijimin e kushteve për zhvillimin e institucioneve të reja financiare ose ristikurimin e atyre ekzistuese në nivel vendor për të ofruar një gamë më të gjerë mundësish (modele) financimi për strehim, të cilat plotësojnë kushtet për të qënë të arrishme dhe të përballueshme nga përfutuesit e synuar. Afërsisht, numri i individëve në pozita të pafavorizuara të cilat do të përftojnë pas zgjerimit të instrumentave financiare do të rritet me 20%.

Arritshmëria

Në strehimin social arritshmëri quhet tërësia e rregullave dhe rregulloreve që u mundësojnë familjeve të kualifikohen dhe të përzgjidhen për strehim social. Identifikimi i grupeve të nënsynuara dhe vendosja e prioriteteve, si edhe vendosja e kuotave për grupet specifike të synuara, mund të rrisin arritshmërinë.

5-OBJEKTIVAT

- Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfutuar nga këto programe në bashkinë Patos.
- Vlerësimi i nevojave për strehim në bashkinë Patos, fokusimi i grupeve në pozita të pafavorizuara.
- Mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në bashkinë Patos.
- Reduktimi i familjeve të pastreha

-Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfutuar nga këto programe në bashkinë Patos

Deri më tani në bashkinë Patos janë vlerësuar dhe zbatuar pesë lloj programesh.

Po rendisim programet sipas zbatimit të tyre:

- a) Banesa sociale me qira për gratë kryefamiljare (12 Apartamente).
- b) Banesa sociale me qira (14 familje) duke përfshirë të gjitha grupet shoqërore (ish qendra e kualifikimit) SH1.
- c) Banesa sociale me qira (31 familje) duke përfshirë të gjitha grupet shoqërore (ish qendra e kualifikimit) SH2.
- d) Grante të vogla për përmirësim banesash (57 shtëpi banimi individuale familje në nevojë).
- e) Rimbursim qiraje në masën 50% të vlerës së tregut (për familjet aplikuese në nevojë) deri më sot 4 familje.
- f) Banesa me kosto të ulët (16 familje) kredit të zbutura.

- Vlerësimi i nevojave për strehim në bashkinë Patos, fokusimi i grupeve në pozita të pafavorizuara.

Aktualisht nevojat për strehim social në bashkinë Patos, janë 113 kërkesa të ndara në nëngrupe sipas programeve.

Programet:

- | | |
|---------------------------|------------|
| - Rikonstruksion banesash | 37 familje |
| - Banesa sociale me qira | 74 familje |
| - Subversion qiraje | 2 familje |

Nëngrupet:

Gra kryefamiljare	33 familje
Persona me aftësi të kufizuar	2 familje
Komunitete Rom-Egjyptian	5 familje
Të moshuar	14 familje
Familje me ndihmë ekonomike	12 familje

Pavarësisht situatës së paraqitur, kemi evidentuar edhe grupe të tjera shoqërore në nevojë për përmirësim banesë, sidomos në zonat rurale, pavarësisht se nuk kanë aplikuar për arsye të ndryshme (nuk kanë informacion). Ky numër familjesh arrin rreth 30 familje.

- Do të përgatiten preventivat përkatëse për çdo objekt si dhe po shihet mundësia e financimit të tyre dhe me donator, duke marrë parasysh edhe pozitën e tyre shoqërore.

- Në objektet e transferuara bashkisë Patos, të cilat një pjesë e mirë e tyre janë pa funksion, do të ndërhyet për përmisimin e tyre, duke zgjidhur kështu dhe pjesë më të mira të familjeve. Do të përgatiten projekte për aplikim rikonstruksion total nga pushteti qendror-vendor ku do të kërkohet mbështetje financiare për strehimin 25-30 familje.
- Gjithashtu, në këto objekte do të bëhet formalizimi i ligjor me familjet poseduese.
- Do të synohet ngritja e një qendre për banesa të specializuara për grupe shoqërore të pafavorizuara.

- Mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në bashkinë Patos.

- ✓ Do të punohet në vazhdimësi për mbledhjen e të dhënave për familjet në nevojë.
- ✓ Evidentimi i tyre do të bëhet në bashkëpunim me aktor të tjerë: administratorët e njësisë, kryetarët e fshatrave, Shërbimi Social, Zyra e Punës dhe grupet e interesit.
- ✓ Do të krijohet një databazë me sistemin e të dhënave që të jetë i aksesueshëm, transparent në çdo kohë nga vetë qytetarët.

- Reduktimi i familjeve të pastreha

Ky është synimi kryesor për bashkinë Patos.


- ✓ Me planin e strehimit 2019-2024 u realizuan disa projekte, ku sot aktualisht bashkia Patos posedon 59 apartamente me qira. Gjithashtu u përmisuan 57 shtëpi banimi individuale nga të gjithat grupet shoqërore.
- ✓ Për vitin 2025 – 2029 synohet rikonstruksion banesë për 60 familje në nevojë nga të gjitha grupet shoqërore, si dhe rikonstruksionin e ish kabanonit në lagjen 29 Marsi.
- ✓ Do të krijohet një fond strehimi.
- ✓ Do të vazhdojmë ofrimin e trullit të lirë për investim nga ENTI Kombëtar i Banesave për 30 apartamente me sipërfaqe të ndryshme (1+1 dhe 2+1), ku do të përfshihen të gjithë grupet, sidomos çiftet e reja me kredi afatgjata.

- ❖ Hartimi dhe realizimi i këtij Plani 5- vjeçar të strehimit për vitet 2025-2029, synon reduktimin dhe zgjidhjen e problemit të strehimit në territorin e bashkisë Patos deri në masën 85 % të familjeve të pastreha.

Referenca

MFE, 2016-2025: Strategjia Kombëtare e Strehimit Social MFE, UNDP, 2021: Udhëzuesi për Strehimin Social në nivel Bashkie, Leave no one behind. Regjistri i Gjendjes Civile Bashkia Patos, viti 2025
Ligji nr. 22/ 2018 “Për strehimin Social”
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Grupi i punës

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
 Ina Sauli	 Emenita Mici	 Arben Shpërdheja	 Anisa Kripa
	 Andi Kola	 Fabjola Hoxha	 Nurke Haziraj